



Subjekti Politik
Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës

Raportet financiare të fushatës dhe Raporti i Auditorëve të pavarur

Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës
16 Shtator 2021 deri me 12 Nentor 2021

Përmbajtja:

Raport i auditorëve të Pavarur..	3
Pasqyra e Pozitës Financiare.....	6
Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve.....	7
Informacionet e përgjithshme	8
Shënimet e pasqyrave financiare.....	9-12

Raport i Auditorëve te pavarur

Drejtuar Kryesisë së Subjektit Politik Aleanca për Ardhmerinë e Kosovës

Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

Opinion

Ne kemi audituar raportet financiare të fushatës për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës të bashkëngjitura të Subjektit Politik **Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës - AAK** (në vijim referuar si “Subjekti Politik” apo “SP”), të përbëra nga Pasqyra e Pozitës Financiare me 12 Nentor 2021, Pasqyra e të Hyrave dhe Shpenzimeve për periudhën 16 Shtator 2021 deri me 12 Nentor 2021, dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshira në faqe 9-12.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të bashkëngjitura paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të subjektit Politik me datën 12 Nentor 2021, dhe të hyrat dhe shpenzimet për periudhën 16 Shtator 2021 deri me 12 Nentor 2021, në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike dhe me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058.

Bazat për Opinion

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në Përgjegjësitë e Auditorit në paragrafin për Auditimin e Pasqyrave Financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Subjekti Politik në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

Theksim i çështjes

Pa e kualifikuar opinionin tonë në tërheqim vëmendjen në lidhje me gjetjet e mëposhtme:

- Për këtë periudhë (fushatë) lidhur me blerjet e kryera nga Subjekti Politik, nuk kemi deshmi mbi zbatimin e procedurave të prokurimit ashtu siç është paraparë edhe me nenin 2 të Rregullorës së brendshme financiare të SP të aprovuar me 20 Dhjetor 2020 e cila do të mundësonte një shfrytëzim sa më efikas, me kosto ekonomike, transparente dhe të drejtë të fondeve të subjektit politik.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre te ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitet sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse



këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit & Conto sh.p.k

Haxhi Nimanaj
Auditor Ligjor
18 Tetor 2023

ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS

Pasqyrat Financiare të fushatës Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës
16 Shtator 2021 deri me 12 Nentor 2021

Pasqyra e Pozitës Financiare

Pasuritë		Bilanci në fundë të periudhës	Bilanci në fillim të periudhës
Pasuritë afatgjata	Shënimi	Shuma në Euro	Shuma në Euro
Toka, objektet dhe pajisjet	5		
Pasuritë e paprekshme			
Pasuritë tjera afatgjata			25,569.70
Total pasuritë afatgjata			25,569.70
Pasuritë afatshkurtra			
Llogaritë e arkëtueshme	6		
Parapagimet			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	7	8,898.18	723.30
Pasuritë tjera afatshkurtra			
Total pasuritë afatshkurtra		8,898.18	723.30
Total pasuritë		8,898.18	26,293.00
Ekuiteti			
Fondet e akumuluar		26,293.00	26,293.00
Suficiti / (deficiti) i vitit		(32,694.82)	
Total Ekuiteti		(6,401.82)	26,293.00
Detyrimet			
Detyrimet afatgjata			
Huat e pagueshme			
Të hyrat e shtyra			
Gjithsej detyrimet afatgjata		0.00	0.00
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	8	15,000.00	
Huatë e pagueshme			
Detyrimet tjera afatshkurtra	9	300.00	
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		15,300.00	0.00
Gjithsej detyrimet		15,300.00	0.00
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		8,898.18	26,293.00

ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS

Pasqyrat Financiare të fushatës Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës

16 Shtator 2021 deri me 12 Nentor 2021

Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve

	Shënimi	16 Shtator 2021 deri me 12 Nentor 2021
Të hyrat		
Të hyrat nga buxheti		
Të hyrat nga anëtarësia		
Donacionet dhe kontributet në të holla	3	2,250.00
Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime	4	
Të hyrat tjera		
Gjithsej të hyrat për fushatë		2,250.00
Shpenzimet		
Pagat dhe kompensimet	2	0.00
Shpenzimet e transportit	2	25.00
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	2	30,976.56
Blerja e mallrave	2	516.26
Shpenzimet e përgjithshme	2	300.00
Shpenzimet e ndryshme	2	3,127.00
Gjithsej shpenzimet për fushatë	2	34,944.82
Suficiti / (deficiti) për fushatë		(32,694.82)

1. Informata te përgjithshme

Aleanca për Ardhmerinë e Kosovës është Subjekt politik i certifikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Adresa e Subjektit Politik: Rr.“Dëshmorët e Kombit” Prishtinë

Kryetari i SP për vitin 2021 është: Ramush Haradinaj

Zyrtar financiar: Lulzim Leci

Pasqyrat financiare te SP në Kosovë janë përgatitur sipas kërkesave te Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar.

Bazuar në nenin 19 paragrafi 2 pika 7 e Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 ,Subjekti i regjistruar politik brenda pesë (5) ditëve të punës nga marrja e draft raporteve të audituara ka dorëzuar raportin e rishikuar financiar dhe shpjegimet lidhur me gabimet ose lëshimet të identifikuara nga auditorët.

Subjekti Politik mirëmban vetëm një llogari të vetme bankare në Raiffeisen Bank Kosovo.

ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS*Shënimet për Pasqyrat Financiare të fushatës 16 Shtator 2021 deri me 12 Nentor 2021**Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës***Shënimi 2: Shpenzimet**

Shpenzimet	Shpenzimi në Euro	Pagesa në Euro	Borxhi i mbetur në Euro
Pagat dhe kompensimet			
Pagat dhe kompensimet, neto			
Pagesat e vëzhguesve			
Kontributet pensionale të punëmarrësit			
Kontributet pensionale të punëdhënësit			
Tatimet në të ardhura personale			
Beneficionet tjera			
Gjithsej			-
Shpenzimet e transportit			
Automjetet motorike të huazuara			
Karburantet			
Biletat, aeroplanit/autobusit/trenit/taksitë etj.	25.00	25.00	0.00
Sigurimi dhe mirëmbajtja e veturave			
Çdo shpenzim tjetër i transportit			
Gjithsej shpenzimet e transportit	25.00	25.00	0.00
Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat			
Hapesira, lokale, zyra dhe objekte tjera me qira	1,800.00	1,800.00	0.00
Ushqimi	25,000.00	10,000.00	15,000.00
Aktivitete kulturore dhe rekreative			
Radio dhe spotet televizive			
Stendat e afishimit dhe reklamimet në gazeta			
Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave	4,176.56	4,176.56	0.00
Gjithsej reklammat, reprezentacioni dhe konferencat	30,976.56	15,976.56	15,000.00
Blerja e mallrave			
Furnizimi i zyrës	516.26	516.26	0.00
Pajisjet të vogla			
Gjithsej blerja e mallrave	516.26	516.26	0.00
Shpenzimet e përgjithshme			
Telefoni, interneti dhe posta			
Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat)			
Gjopa dhe ndeshkime	300.00	0.00	300.00
Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet ne natyrë në mallra dhe shërbime			
Gjithsej shpenzimet e përgjithshme	300.00	0.00	300.00
Shpenzimet e ndryshme			
Mirëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës			
Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër	3,127.00	3,127.00	0.00
Gjithsej shpenzimet e ndryshme	3,127.00	3,127.00	0.00
Gjithsej shpenzimet	34,944.82	19,644.82	15,300.00

ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS*Shënimet për Pasqyrat Financiare të fushatës 16 Shtator 2021 deri me 12 Nentor 2021**Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës***Shënimi 3: Donacionet dhe kontributet në të holla**

Pranuar nga				Vlera	E pranuar përmes:	
Kontribuesi	Adresa	Numri personal	Data kur është dhënë kontributi	në euro	Bankë	Arkë
Fluidi sh.p.k.	Prishtinë		22.09.2021	2,000.00	Bankë	
Lulzim Leci	Prishtinë		01.10.2021	250.00	Bankë	
Gjithsej donacionet dhe kontributet në të holla				2,250.00	0.00	0.00

Shënimi 4: Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime

Përshkrimi i mallit / shërbimit	Pranuar nga				Vlera
	Kontribuesi	Adresa	Numri personal	Data kur është dhënë kontributi	në euro
Gjithsej kontributet në natyrë në mall dhe shërbime					0.00

Shënimi 5: Toka, objektet dhe pajisjet**Për periudhën: 16 Shtator 2021 deri me 12 Nentor 2021**

	Blerjet gjatë periudhës
Toka	
Objektet	
Veturat	
Pajisjet e zyrës	
Pajisjet e teknologjisë informative	
Pajisjet tjera	
Gjithsej toka, objektet dhe pajisjet	////////////////////

ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS

Shënimet për Pasqyrat Financiare të fushatës 16 Shtator 2021 deri me 12 Nentor 2021

Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës

Shënime tjera

Shënimi 6. Llogari të arkëtueshme	Bilanci në fundë të periudhës Shuma në Euro	Bilanci në fillim të periudhës Shuma në Euro
Blerësi 1		
Blerësi 2		
Gjithsej Llogarit e arkëtueshme	//////////	//////////

Shënimi 7. Paraja dhe ekuivalentët e parasë	Bilanci në fundë të periudhës Shuma në Euro	Bilanci në fillim të periudhës Shuma në Euro
Paraja në bankë	8,898.18	723.30
Paraja në arkë		
Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë	8,898.18	723.30

Shënimi 8. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	Bilanci në fundë të periudhës Shuma në Euro	Bilanci në fillim të periudhës Shuma në Euro
“Te Fahria”	15,000.00	
Furnitori 2		
Furnitori 3		
Llogari të pagueshme të tjera	0.00	
Gjithsej llogaritë e pagueshme dhe të tjera	15,000.00	0.00

Shënimi 9. Detyrimet tjera afatshkurtra	Bilanci në fundë të periudhës Shuma në Euro	Bilanci në fillim të periudhës Shuma në Euro
Detyrimet për paga dhe tatime		
Detyrimet për qira		
Detyrimet për gjoba dhe ndëshkime	300	
Detyrime tjera afatshkurtër (huazimet)		
Gjithsej detyrimet tjera afatshkurtra	300.00	0.00

